VENDIM
Nr. 59, datë 3.6.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC TRESKA" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HECET "TRESKA 2", "TRESKA 3" DHE "TRESKA 4"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa "a" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pikat 1, 3 dhe 4 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa "a" të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.6.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "HEC Treska" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "HEC Treska" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "HEC Treska" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet "Treska 2", "Treska 3" dhe "Treska 4".
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani